



We know how...

Pozicioni: Inxhinier

Drejtoria: Teknike

Vendndodhja: zyra Tirane ose Lushnje

Rreth nesh

LLAZO eshte krijuar ne vitin 2002 dhe është një ndërmarrje private familjare, me aftësi të klasit të parë në shërbim të gjithë zinxhirit të nevojave të klientit në sektorin e ndërtimit. Ne operojmë sipas një modeli biznesi të integruar që përfshin gamën e plotë të shërbimeve si studim, projektim, prodhim, ndërtim, investim, operim dhe mirëmbajtje, duke ofruar zgjidhje për shoqëritë publike dhe private në Shqipëri.

Selia qendrore e shoqërisë ndodhet ne Lushnje.

Me shume info: www.llazo.al

Pershkrimi i pozicionit te punes

- Rolin e konsulent teknik për drejtuesit e shoqërisë, klient apo investitore potencial.
- Harton dhe vë në zbatim Projekt-organizimin e punimeve, planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, planin e veprimeve për ndërtimin e objektit. Menaxhim i zbatimit të projekteve, identifikimin e problemeve dhe përshtatjen e metodave të reja në çdo aktivitet.
- Te hartohet metodologjia e ndërtimit edhe ndiqet zbatimi i grafikut të punimeve, i cili duhet të jetë me date reale dhe objektiva të matshme. Menaxhoje stafin apo kantierin, percaktimin dhe hartimin e detyrave apo menyrën e kryerjes së proceseve të punës.
- Ndjekjen e kostos në mënyrë periodike gjatë fazës së ndërtimit të objekteve. Te hartohet edhe azhurnohet progresivisht kosto e zbatimit të punimeve, dhe kohezgjatja e punimeve. Hartim raporte dhe statistika kosto për projekte.
- Mbajtja e të gjithë korrespondencës së nevojshme me autoritetet kontraktore (Bashki, Ministri, Fondacionet e huaja apo Klientet private) për çdo sqarim dhe kërkesë që mund të ketë gjatë fazës së përgatitjes së dokumentacionit për çdo procedurë prokurimi apo gjatë fazës së zbatimit.
- Përgatitja e situacioneve mujore, proces-verbaleve ndryshem, librezës së masave, ditarin e objektit, instruktimin mujor teknik, analizë të cmimeve duke përfshirë kontrollin e situacioneve të nënkontraktorëve dhe përgatitjen e situacionit përmbledhës për objektet.
- Rakordim javor/mujor me financën për inventarët, gjendjen në magazinë dhe shkarkimin e materialeve. Kontrolli mujor i inventarëve për materialet. Te hartohet flete dalje nga magazine Brenda dates 30 të muajit aktual, e cila do të shërbejë si dokument zyrtar për kontrollin tatimor. Te jetë pastër e qartë e rregullt. Cdo ditë të hënë të javës, duhet të bëhet rakordimi i gjendjeve të magazines për çdo kantier, duke ndjekur ecurinë e punimeve edhe blerjet e materialeve.
- Parashikimi i blerjes së mallrave që do të situacionohen në atë periudhë. brenda dates 15 të muajit aktual si edhe ndjekja e tyre, porosi dorezim, kontabilizim çdo ditë.
- Menaxhim i proceseve dhe dokumentacionit teknik-ligjor për linjen e prodhimit të betonit, regjistri

i mostrave betoneve, certificate cilesise, raport testimet.

- Kontroll periodik i legjislacionit perkates dhe botimeve ne Fletoren zyrtare, në lidhje me KTZ, rregulloret, vendimet KM, çështje të kostove të ndërtimit dhe procedurave të kontrollit tatimor .
- Identifikimi dhe angazhimi personal për marrja e masave për përmbushjen e kuadrit ligjor dhe etik nga cdo punonjes, nenkontraktor në cdo aktivitet apo objekt te kontraktuar. Parashikimi dhe Eliminimi i cdo shkelje ligjore. Do të jetë personi I kontaktit me organet ligjë-zbatuese.
- Hartimi edhe menaxhimi dosjes me cmimet e artikujve apo shërbimeve të nevojshme. (oferta shërbimi nënkontraktor apo furnitorë material ndertimi).Negocimi I ofertave
- Nese shihet e nevojshme të behen rekomandime në përcaktimin e kushteve të kontratave ndryshme, sipermarrje, Joint-Venture, porosie.
- Te hartohet honoraret per punes per cdo project koherent.
- Te behet rakordimi mujor me nenkontraktoret
- Te rekomandoj dhe krijoj liste per mjetet edhe vegla qe shoqeria duhet te kete ne dispozicion, qira, pronesi.
- Te drejtoj procesin e prokurimit, te krijoj kontakte me individe apo shoqeri te ndryshme kombetare apo nderkombetare te c ilat mund te ofrojne produkte aposherbime te nevojshme. Te hartoj raporte apo statistika.
- Te rekomandoj investime ne pajisje,mjete, teknologji qe mund te sjell perfitim ne kohe,kosto,cilesi dhe sjell avantazh ne treg.
- Te rekomandoj ndryshime apo shtesa ne punonjes te kualifikuar apo inxhiniere.
- Te krijoj dhe mbaj kontakte me drejtores urbanistik ne Bashkine te ndryshme, tju ofroje apo negocioj per sherbimet e shoqerise.
- Te krijoj kontakt me fondacionet investuese apo personat pergjegjes.
- Te plotesoj dhe menaxhoj Timesheet (kohemates) javor per kohen e shpenzuar ne secilin project apo aktivitet, ky dokument eshte baza mbi te cilen do te llogariten bonus dhe shperndahen kosto e secilit project.

AFTESITE DHE KUALIFIKIMET

- Mosha 25-50 vjeç
- Te zoteroje diplome universitare ne Inxhineri Ndertimi
- Aftesine koordinimi ne projektim/ndertim ndermjet disiplinave te ndryshme inxhinierike.
- Aftesi shume te mira komunikimi dhe aftesi nderpersonale.
- Te kete njohuri ne proceset dhe materialet e ndertimit, si dhe ne menaxhimin e projektit.
- Eksperience ne CAD, Revit, Tekla, Sap 2000, paketes Office dhe Project.
- Tet e kete aftesi shume te mira te te menduarit ne menyre kritike dhe te shkruarit raporte teknike, relacione, shkresa, oponenca.
- Te kete njohuri te gjuhes angleze
- Koherenca dhe njohja e industrise se ndertimit kombetare dhe nderkombetare.
- Aftesi per te promovuar shoqerine, krijimin e kontakteve, shtimin e klienteles.
- Aftesi shume te mira ne zgjidhjen e problemeve komplekse.
- Aftesi shume te mira ne negociim e marreveshjeve dhe kontratave.

CFARE OFROJME NE

- Pagë Bazë e krahasueshme me pozicionet me të mirat në sektorin privat dhe publik.
- Bonus + shpërblime me arritjen e objektivave.
- Sistem pagese sipas vjetërsisë.
- Trajnime dhe mbështetje financiare për rritjen profesionale
- Aktivitete social-kulturore.
- Ambjent pune shumë miqësor dhe komod.

Ne do te bejme cmos qe ju te ecni perpara!

Sepse ne, tek LLAZO, ofrojme mundesite me te mira per te zhvilluar ambiciet dhe pasionet tuaja profesionale dhe personale. Ofrojme nje vend pune plote mundesi per tu angazhuar ne disa nga projektet me te vecanta te ndertimit. Ju do te jeni bashkepunetore dhe do te ndermerrni nje rol aktiv ne krijimin e projekteve me impakte pozitive sociale. Do te punoni dhe jetoni cdo dite ne nje ambjent pune plote energji pozitive, inkurajues dhe plot mbeshtetje per te drejtuar, mesuar dhe u zhvilluar profesionalisht.

Kandidatet e interesuar jane te lutur te dergojne CV-ne, diplomen dhe nje leter motivimi ne adresen e email-it info@llazo.al me pershkrim: **Punesimi-Ing.X.Y** deri me date 30/03/2020. Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen per interviste.

LLAZO garanton qe te dhenat e kandidateve do te trajohen me konfidencialitet maksimal.